A.K.P.A.
Nr 2468/8 Prot.
Datë,më 07 10 2024

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr 8449/1 Prot. Tiranë, më 19.09.2024

**Lënda:** Kërkesë për publikim të njoftimit.

**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**TIRANË**

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, të Kreut II, të pikës 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", të ndryshuar dhe të Kreut III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*", të ndryshuar, kërkon publikimin në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të njoftimit për shpalljen për konkurrim për pozicionet si më poshtë:

- **2 (dy) Specialist për Raportimet pranë Bashkimit Europian, Kategoria ekzekutive, Klasa IV-1**
- **1 (një) Specialist i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes, Kategoria ekzekutive IV-1**
- **1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Raportimeve pranë Bashkimit Europian, Kategoria e ulët drejtuese, klasa III-1**

Bashkëlidhur, do të gjeni Njoftimin për shpallje nr. 876 prot., datë 18.09.2024, nr. 878 prot., datë 18.09.2024 dhe nr. 877 prot., datë 18.09.2024për pozicionin e sipërpërmendur.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

**KANCELAR**

**Laureta Binaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr.876 Prot. Tiranë, më 18.09.2024

**Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil në kategorinë ekzekutive të pozicionit "Specialist për Raportimet pranë Bashkimit Europian", në Sektorin e Raportimeve pranë Bashkimit Europian, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.**

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*, të ndryshuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive në pozicionin:

- **2 (dy) Specialist për Raportimet pranë Bashkimit Europian, në Sektorin e Raportimeve pranë Bashkimit Europian, Kategoria ekzekutive, klasa IV-1**

Pozicioni i mësipërm, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

| | |
|---|---|
| **Afati për dorëzimin e dokumentave për:**<br><br>LËVIZJE PARALELE | data 29/09/2024 |

| | |
|---|---|
| **Afati për dorëzimin e dokumentave për:**<br><br>PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL | data 04/10/2024 |

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

1. ndjek procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, në kuadër të Kriterit Politik dhe Kapitullit 23 të acquis "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kapitullit 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria" si dhe kapitujve të tjerë, ku Prokuroria e Posaçme është institucion kontribues;
2. ndjek dhe finalizon kontributet e Prokurorisë së Posaçme për raportin e Komisionit Evropian, Komitetin e Stabilizim Asocimit, Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, si dhe Nënkomiteteve të tjera Bashkim Europian-Shqipëri;
3. kontribuon në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian për kriterin politik dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kapitullin 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria";
4. përgatit raportime për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Zyrën e Kryenegociatorit dhe bashkëpunon me të gjitha institucionet në lidhje me përgatitjet për çeljen e negociatave të antarësimit me Bashkimin Evropian;
5. ndjek të gjitha komunikimet lidhur me përgatitjen e procesit të negociatave të anëtarësimit dhe përgatit materialet për përmbushjen e objektivave në procesin e negociatave;
6. ndjek detyra të ndryshme në përmbushjen e detyrimeve lidhur me procesin e trajnimeve mbi negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian;
7. ndjek detyrimet që lindin nga marrëveshjet me Bashkimin Evropian, si dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare;
8. merr pjesë në hartimin e raporteve në kuadër të raportimeve në institucionet dhe organizmat të tjerë ndërkombëtarë.
9. me miratimin e eprorit përfaqëson Prokurorinë e Posaçme pranë institucioneve dhe për aktivitete që zhvillohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtare;
10. bashkëpunon me Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF) në kuadër të raportimeve mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme në luftën kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
11. harton dhe kthen përgjigje brenda afateve të përcaktuara për kërkesat e sektorit duke respektuar afatet ligjore;
12. kujdeset dhe mbështet bashkëpunimin e Prokurorisë së Posaçme me institucione homologe, me organizma dhe institucione ndërkombëtare, për pjesëmarrjen dhe organizimin e veprimtarive ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit;
13. kontribuon në hartimin e draft akteve rregullatore, strategjive të ndryshme sipas nevojave të strukturave të Prokurorisë së Posaçme, në mbështetje të procedurave të teknikës legjislative;
14. nxjerr dhe përgatit statistika të ndryshme për sektorin në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera të institucionit.

## I. <u>LËVIZJA PARALELE</u>

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

## 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (*të vërtetuar me një dokument nga institucioni*);
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
d) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);
b) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune;
c) Të zotërojë njohuri të mira të një gjuhë të huaj të BE-së, vërtetuar me çertifikatë/diplomë (preferohet gjuha angleze);
d) Preferohet të kenë çertifikata të ndryshme trajnimi;
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Formularët e firmosur sipas nenit 6, paragrafi 1, të ligjit nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", i ndryshuar, sipas linkut të mëposhtëm:
https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr.95-v.2016.pdf
b) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse.
c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, së bashku me një foto, sipas linkut të mëposhtëm:
http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;
d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
e) Fotokopje të certifikatës familjare;
f) Vërtetim të gjëndjes shëndetsore (vlefshmëria maksimumi 3 muaj);
g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt;
h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë (përfshirë çertifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
i) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
k) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës.
l) Certifikatë diplomë që vërteton njohuri të mira të një gjuhë të huaj të BE-së (preferohet gjuha angleze);

m) Deshmi penaliteti/Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
n) Vërtetim nga Gjykata;
o) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
p) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 29.09.2024.**

**Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni e-mail në adresën burimenjerezore@spak.gov.al**

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar;
c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar;
d) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";
e) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar,
f) Njohuritë mbi institucionet e Bashkimit Europian;
g) Njohuri mbi procesin e integrimit evropian;
h) Njohuri mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për negociimin dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian*";

i) Njohuritë mbi ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, *"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare"*;
j) Njohuritë mbi ligjin nr. 43/2016 *"Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"*;
k) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.4.2022 *"Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative"*;
l) Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, të ndryshuar;
m) Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*;
n) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 *"Për rregullat e etikës në administratën publike"*;
o) Njohuritë mbi ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, të ndryshuar;
p) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023, *"Për informacionin e klasifikuar"*;
q) Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë"*.

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, sipas rubrikës së vlerësimit të mëposhtme:

a) 20 pikë për përvojen.
b) 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse.
c) 10 pikë për certifikimin pozitiv;

Totali i pikëve në përfundim për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur"*, të Departamentit të Administratës Publike, faqa zyrtare www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Prokuroria e Posaçme do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin "Shërbimi Kombëtari Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

## II. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe stendat e informimit me publikun të institucionit.*

## 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidatët në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

a) Të jetë shtetas shqiptar;
b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
f) Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar;
g) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);
b) Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune;
c) Të zotërojë njohuri të mira të një gjuhë të huaj të BE-së, vërtetuar me çertifikatë/diplomë (preferohet gjuha angleze);
d) Preferohet të kenë çertifikata të ndryshme trajnimi;
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Formularët e firmosur sipas nenit 6, paragrafi 1, të ligjit nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar, sipas linkut të mëposhtëm: https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr.95-v.2016.pdf
b) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse,
c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, së bashku me një foto, sipas linkut të mëposhtëm: http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;
d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e) Fotokopje të certificates familjare;
f) Vërtetim të gjendjes shëndetsore (vlefshmëria maksimumi 3 muaj);
g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt;
h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë dhe Diplomën Bachelor (përfshirë çertifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*;
i) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
j) Certifikate/diplomë që vërteton njohuri të mira të një gjuhë të huaj të BE-së. (preferohet gjuha angleze);
k) Deshmi penaliteti/Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
l) Vërtetim nga Gjykata;
m) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
n) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, lerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 04.10.2024.**

Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni e-mail në adresën burimenjerezore@spak.gov.al

*Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.*

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSISTË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar;
c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar;
d) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";
e) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar,
f) Njohuritë mbi institucionet e Bashkimit Europian;
g) Njohuri mbi procesin e integrimit evropian;
h) Njohuri mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për negociimin dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian*";
i) Njohuritë mbi ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, "*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare*";
j) Njohuritë mbi ligjin nr. 43/2016 "*Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë*";
k) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.4.2022 "*Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative*";
l) Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", të ndryshuar;
m) Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*";
n) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*";

o) Njohuritë mbi ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"*, të ndryshuar;
p) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023 *"Për informacionin e klasifikuar"*.
q) Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë"*.

## 2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, sipas rubrikës së vlerësimit të mëposhtme:

a) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën (deri në 15 pikë);
b) Vlerësim me shkrim. (deri në 60 pikë);
c) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën. (deri në 25 pikë)

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.

Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur"*, të Departamentit të Administratës Publike, faqa zyrtare www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail) nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi rezultatin vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit, si dhe për intervistën strukturuar me gojë.

Në përfundim të afatit të ankimimit, Prokuroria e Posaçme, do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidatë fitues janë kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (70% të pikëve), duke u renditur nga kandidati me rezultatin më të lartë.

*Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil do të njoftohen për [illegible] të kësaj procedure:*

*- për datën e daljes së [illegible]*

*- datat, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi*

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe stendën e informimit me publikun të institucionit.*

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**Altin Dumani**

**ME URDHËR DHE ME DELEGIM**
**DREJTUESI I CAKTUAR**

**Adnan Xholi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 877 Prot. Tiranë, më 18.09.2024

**Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për kategorinë e ulët drejtuese, në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Raportimeve pranë Bashkimit Europian", në Sektorin e Raportimeve pranë Bashkimit Europian, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.**

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave *"Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese"*, të ndryshuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritje në detyrë, për pozicionin:

- **1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Raportimeve pranë Bashkimit Europian, në Sektorin e Raportimeve pranë Bashkimit Europian, Kategoria e ulët drejtuese, klasa III-1**

Pozicioni i mësipërm, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

| | |
|---|---|
| **Afati për dorëzimin e dokumentave për:**<br><br>LËVIZJE PARALELE | data 29/09/2024 |

| | |
|---|---|
| Afati për dorëzimin e dokumentave për:<br><br>PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL | data 04.10.2024 |

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. udhëheq dhe ndjek procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, në kuadër të Kriterit Politik dhe Kapitullit 23 të acquis "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kapitullit 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria" si dhe kapitujve të tjerë, ku Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është institucion kontribues;
2. përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të Integrimit Evropian, brenda fushës së përgjegjësisë së Prokurorisë së Posaçme;
3. përfaqëson institucionin në procesin "Screening" për evidentimin e mangësive të legjislacionit shqiptar në kuadër të veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme dhe vlerësimin e mangësive të kapaciteteve institucionale dhe administrative të Kapitullin 23 dhe 24, si dhe çdo kërkesë tjetër specifike sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse;
4. koordinon, ndjek dhe finalizon kontributet e Prokurorisë së Posaçme për raportin e Komisionit Evropian, Komitetin e Stabilizim Asocimit, Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, si dhe Nënkomiteteve të tjera Bashkim Europian-Shqipëri;
5. monitoron dhe kontribuon në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian për kriterin politik dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kapitullin 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria";
6. përgatit raportimet në kuadër të takimeve që kryen Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në lidhje me Kapitulli 23 të acquis "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" dhe Kapitullin 24 "Drejtesia, Liria dhe Siguria";
7. monitoron përgatitjen e raportimeve për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Zyrën e Kryenegociatorit dhe bashkëpunon me të gjitha institucionet në lidhje me përgatitjet për çeljen e negociatave të antarësimit me Bashkimin Evropian;
8. organizon për institucionin zhvillimin e takimeve me Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian dhe koordinon takimet me përfaqësues institucional për këtë çështje;
9. menaxhon të gjitha komunikimet lidhur me përgatitjen e procesit të negociatave të anëtarësimit dhe mbikëqyr përgatitjen e materialeve për përmbushjen e objektivave në procesin e negociatave;
10. monitoron përmbushjen e detyrimeve lidhur me procesin e trajnimeve mbi negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian;
11. monitoron detyrimet që lindin nga marrëveshjet me Bashkimin Evropian, si dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare;
12. organizon punën dhe harton raportet e kërkuara nga strukturat ndërkombëtare si, MONEYVAL, FATF, BE apo organizma të tjerë ndërkombëtarë, mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;
13. monitoron dhe koordinon punën në hartimin e raporteve dhe informacioneve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF-së) Komitetin MONEYVAL të KE, FATF dhe informon periodikisht Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme;

14. kujdeset për përmbushjen në kohë dhe me profesionalizëm të asistencës juridike që jep sektori në procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar të fushës së përgjegjësisë me atë të BE-së, në përputhje me rekomandimet e dhëna në dokumentat strategjike të integrimit, si dhe në harmoni me ligjet e tjera kombëtare;
15. harton projekt propozime për të mundësuar përfitimin e donacioneve sipas nevojave të strukturave të Prokurorisë së Posaçme;
16. përfaqëson Prokurorinë e Posaçme pranë institucioneve dhe për aktivitete që zhvillohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtare;
17. përgatit kontributet/raportet të ndryshme në kuadër të fushës së veprimtarisë së sektorit;
18. organizon dhe koordinon me strukturat e sektorit dhënien e kontributit në hartimin e draft akteve rregullatore, strategjive të ndryshme sipas nevojave të strukturave të Prokurorisë së Posaçme, në mbështetje të procedurave të teknikës legjislative;
19. koordinon punën në procesin e nxjerrjes dhe përgatitjes së statistikave të ndryshme për sektorin në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera të institucionit.

## I. <u>LËVIZJA PARALELE</u>

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës klasë III;
b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (*të vërtetuar me një dokument nga institucioni*);
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".
d) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);
b) Të kenë të paktën 6 (gjashtë) vite përvojë pune në profesion;
c) Të zotërojë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, vërtetuar me çertifikatë/diploma. Njohuri në çdo gjuhë të huaj tjetër përbën avantazh;
d) Preferohet të kenë çertifikata të ndryshme trajnimi;
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## [illegible] MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

a) [illegible] krimin e organizuar, të plotësuar sipas linkut të mëposhtëm
https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr-95-v-2016.pdf

b) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;

c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, së bashku me një foto sipas linkut të mëposhtëm:
http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;

d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e) Fotokopje të certifikatës familjare;

f) Vërtetim të gjëndjes shëndetsore (vlefshmëria maksimumi 3 muaj);

g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt;

h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë (përfshirë certifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*

i) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

k) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;

l) Certifikatë/diplomë që vërteton njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

m) Deshmi penaliteti/Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;

n) Vërtetim nga Gjykata;

o) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;

p) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 29.09.2024.**

**Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni e-mail në adresën burimenjerezore@spak.gov.al**

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

[illegible]

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;

b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar;

c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar;

d) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";

e) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar,

f) Njohuritë mbi institucionet e Bashkimit Europian;

g) Njohuri mbi procesin e integrimit evropian;

h) Njohuri mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për negociimin dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian*";

i) Njohuritë mbi ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, "*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare*";

j) Njohuritë mbi ligjin nr. 43/2016 "*Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë*";

k) Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", të ndryshuar;

l) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.4.2022 "*Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative*";

m) Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*";

n) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*";

o) Njohuritë mbi ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar;

p) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023, "*Për informacionin e klasifikuar*";

q) Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë*"

r) Njohuritë mbi ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*", të ndryshuar;

s) Njohuritë mbi ligjin nr. 157/2013, "*Për masat kundër financimit të terrorizmit*", të ndryshuar.

## [illegible]

Kandidatët do të vlerësohen [illegible] dokumentacionin e dorëzuar [illegible] të mëposhtme:

a) 20 pikë për përvojën;
b) 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse;
c) 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve në përfundim për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike, faqa zyrtare www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Prokuroria e Posaçme do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

## II. NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj procedure, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, ende ka [illegible] [illegible] i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

[illegible]

[illegible]

## 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATËT NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në institucione të tjera të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidatët në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda klasës IV;
b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (*të vërtetuar me një dokument nga institucioni*);
c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë" ose "Shumë mirë";
d) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);
b) Të kenë jo më pak se 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion;
c) Të zotërojë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, vërtetuar me çertifikatë/diploma. Njohuri në çdo gjuhë të huaj tjetër përbën avantazh;
d) Preferohet të kenë çertifikata të ndryshme trajnimi;
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Formularët e firmosur sipas nenit 6, paragrafi 1, të ligjit nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar, sipas linkut të mëposhtëm:
https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr-95-_2016.pdf
b) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse
c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin [illegible] sipas linkut të mëposhtëm
http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard
d) [illegible]
e) [illegible]
f) [illegible]

g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt;
h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë dhe Diplomën |Bachelor (përfshirë çertifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
i) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
j) Certifikate/diplomë që vërteton njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
k) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
l) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
m) Deshmi penaliteti/Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
n) Vërtetim nga Gjykata;
o) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
p) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, lerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 04.10.2024.**

**Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni e-mail në adresën burimenjerezore@spak.gov.al**

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.***

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSISTË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar;
c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar;

d) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";
e) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar.
f) Njohuritë mbi institucionet e Bashkimit Europian;
g) Njohuri mbi procesin e integrimit evropian;
h) Njohuri mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për negociimin dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian*";
i) Njohuritë mbi ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006, "*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare*";
j) Njohuritë mbi ligjin nr. 43/2016 "*Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë*";
k) Njohuritë mbi Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.4.2022 "*Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative*";
l) Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", të ndryshuar;
m) Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*";
n) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*";
o) Njohuritë mbi ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar;
p) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023, "*Për informacionin e klasifikuar*";
q) Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë*";
r) Njohuritë mbi ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*", të ndryshuar;
s) Njohuritë mbi ligjin nr. 157/2013, "*Për masat kundër financimit të terrorizmit*", të ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## 2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen ne lidhje me njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës sipas rubrikës së vlerësimit të mëposhtme:

a) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën (deri në 20 pikë);
b) Vlerësim me shkrim, (deri në 40 pikë);
c) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, (deri në 40 pikë)

[illegible] ... të Departamentit të Administratës Publike, faqja zyrtare www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mbi rezultatin vlerësimit të testimit me shkrim vlerësimit të jetëshkrimit, si dhe për intervistën strukturuar me gojë.

Në përfundim të procesit të ankimimit, Prokuroria e Posaçme, do të shpallë listën e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidatë fitues janë kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (70% të pikë), duke u renditur nga kandidati me rezultatin më të lartë.

*Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:*

*- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak*

*- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.*

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe stendat e informimit me publikun të institucionit*

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**Altin Dumani**

ME URDHËR DHE ME DELEGIM

DREJTUESI I CAKTUAR

Adnan Xholi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 879 Prot. Tiranë, më 18.09.2024

**Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil në kategorinë ekzekutive të pozicionit "Specialist i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes", në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetime të Përbashkëta, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.**

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*, të ndryshuar, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive në pozicionin:

- **1 (një) Specialist i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes, në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetime të Përbashkëta, Kategoria ekzekutive, klasa IV-1**

Pozicioni i mësipërm, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

| | |
|---|---|
| **Afati për dorëzimin e dokumentave për:**<br><br>LËVIZJE PARALELE | datë 29/09/2024 |

| | |
|---|---|
| **Afati për dorëzimin e dokumentave për:**<br><br>PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL | datë [illegible] |

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

1. administron tërësinë e dokumenteve dhe akteve proceduriale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare, të pranuara/marra nga Prokurori i Posaçëm;
2. bashkëpunon me autoritete kompetente të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare;
3. me miratimin e eprorit mbikëqyr hetimet e përbashkëta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, zbatimin e legjislacionit të brendshëm, si dhe respektimin e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë;
4. informon Drejtuesin e Sektorit dhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme në lidhje me problemet e identifikuara, të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve me organet kompetente të një shteti tjetër apo përfaqësuesve të tij;
5. realizon komunikimin dhe bashkëpunimin me autoritetet e shteteve të tjera me qëllim marrjen e kërkesave për kryerjen e hetimeve të posaçme për çështjen penale, si dhe ofron ndihmë ligjore në procedime për vepra penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale;
6. me miratimin e eprorit mbikëqyr veprimtarinë e organit kompetent të shtetit të huaj, që është i autorizuar të veprojë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në rast të një çështjeje penale urgjente, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të qytetarëve shqiptarë;
7. kryen veprime proceduriale për kërkesat për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta bazuar në Konventa Ndërkombëtare, Kodin e Procedurës Penale, etj.;
8. vepron si ndërlidhës me autoritetet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta, ekstradimeve, marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Interpol-it, Prokurorin Shqiptar Ndërlidhës në Eurojust, Oficerët Ndërlidhës të atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë, etj.
9. merr masa për ekzekutimin brenda afateve ligjore të kërkesave në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çeshtjet penale, përfshirë këtu ekstradimet, transferimet e të dënuarve, letërporositë ndërkombëtare, transferimet e proçedimeve duke u udhëhequr nga Drejtuesi i Sektorit;
10. përgatit programin për shërbimin apo vizitën jashtë shtetit, të punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, për aktivitete të ndryshme, pas miratimit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur komunikimet elektronike me organizatorët, në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
11. përgatit kontributet/raportet të ndryshme në kuadër të fushës së veprimtarisë së sektorit;
12. respekton legjislacionin kombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Klasifikimin e Informacionit "Sekret Shtetëror", në çdo shkëmbim informacioni ndërmjet zyrave homologe;
13. nxjerr dhe përgatit statistika të ndryshme për sektorin në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera të institucionit.

## I. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

## 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, [illegible] kategori [illegible];
b) Të mos kenë masë disiplinore [illegible] institucionit;
c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë";
d) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi)*;
b) Të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e drejtësisë;
c) Të zotërojë njohuri të mira të gjuhës angleze, vërtetuar me çertifikatë/diplomë;
d) Preferohet të kenë çertifikata të ndryshme trajnimi;
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Formularët e firmosur sipas nenit 6, paragrafi 1, të ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, i ndryshuar, sipas linkut të mëposhtëm:
https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr.95-x-2016.pdf
b) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse.
c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, së bashku me një foto, sipas linkut të mëposhtëm:
http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;
d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
e) Fotokopje të certifikatës familjare;
f) Vërtetim të gjëndjes shëndetsore (vlefshmëria maksimumi 3 muaj).
g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt.
h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë (përfshirë çertifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përfshirë njehsimi nga Ministria [illegible]*.
i) [illegible]
j) [illegible]
k) [illegible]
l) [illegible]
m) [illegible]

n) Vërtetim nga Gjykata;
o) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
p) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 29.09.2024.**

**Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni e-mail në adresën burimenjerezore@spak.gov.al**

***Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.***

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, të ndryshuar;
c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar;
d) Njohuritë mbi ligjin nr. 7895, datë 27.01.1997 *"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"* të ndryshuar;
e) Njohuritë mbi ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 *"Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë"* të ndryshuar;
f) Njohuritë mbi ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 *"Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale"*, të ndryshuar;
g) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*;
h) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 *"Për Nëpunësin Civil"*, të ndryshuar.

[illegible]

[illegible]

k) Njohuritë mbi ligjin nr. [illegible], datë [illegible] "Për [illegible] *publike*";

l) Njohuritë mbi ligjin nr. 8367, datë 07.0[illegible] "*Për [illegible] konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar;

m) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023 "Për *informacionin e klasifikuar*";

n) Njohuritë mbi ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në fushën penale" dhe protokollin e saj shtesë*";

o) Njohuritë mbi ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale"*";

p) Njohuritë mbi ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 "*Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe të dy protokolleve shtesë të saj*";

q) Njohuri mbi ligjin nr. 8499, datë 10.06.1999 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar"*";

r) Njohuri mbi ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë"*".

## 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, sipas rubrikës së vlerësimit të mëposhtme:

a) 20 pikë për përvojen.
b) 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse.
c) 10 pikë për certifikimin pozitiv.

Totali i pikëve në përfundim për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin, me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve [illegible]

http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/[illegible]

## 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Prokuroria e Posaçme do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin "Shërbimi Kombëtari Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

# II. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe stendat e informimit me publikun të institucionit.*

## 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

a) Të jetë shtetas shqiptar;
b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
f) Të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar;
g) Për t'u pranuar në shërbimet e Prokurorisë së Posaçme, kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë të caktuara me ligj të veçantë, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar nga kandidati dhe familjarët e afërm të kandidatit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a) Të [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible]

b) Të ketë jo më pak se 5 vite përvojë pune në fushën e drejtësisë;
c) Të zotërojë njohuri të mira të gjuhës angleze, vërtetuar me certifikatë/diplomë;
d) Preferohet të ketë certifikata të ndryshme trajnimi.
e) Kandidati i shpallur fitues do t'i nënshtrohet procedurave për pajisjen me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
f) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

a) Formularët e firmosur sipas nenit 6, paragrafi 1, të ligjit nr. 95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, të ndryshuar, sipas linkut të mëposhtëm:
https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/formularet-sipas-ligjit-nr.95-x.2016.pdf
b) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse.
c) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass, së bashku me një foto, sipas linkut të mëposhtëm:
http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard;
d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
e) Fotokopje të certifikatës familjare;
f) Vërtetim të gjendjes shëndetsore (vlefshmëria maksimumi 3 muaj);
g) Vlerësimi i fundit nga eprori direkt;
h) Kopje të noterizuar të Diplomës së Shkollës së Lartë dhe Diplomën Bachelor (përfshirë çertifikatën e notave). *Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;*
i) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
j) Certifikatë/diplomë që vërteton njohuri të mira të një gjuhë të huaj të BE-së, (preferohet gjuha angleze);
k) Deshmi penaliteti/Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
l) Vërtetim nga Gjykata;
m) Vërtetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht;
n) Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, lerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV e kandidatit.

**Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Prokurorisë së Posaçme pranë Zyrës së Protokollit në adresën: Rruga: "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, brenda datës 04.10.2024.**

[illegible]

*Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për s'kualifikim të kandidatit.*

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia përgjegjëse e Prokurorisë së Posaçme për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSISTË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
b) Njohuritë mbi ligjin nr. 95/2016, "*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*", të ndryshuar;
c) Njohuritë mbi ligjin nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar;
d) Njohuritë mbi ligjin nr. 7895, datë 27.01.1997 "*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*" të ndryshuar;
e) Njohuritë mbi ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "*Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*" të ndryshuar;
f) Njohuritë mbi ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 "*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale*", të ndryshuar;
g) Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";
h) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", të ndryshuar,
i) Njohuritë mbi ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", të ndryshuar;
j) Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*";
k) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*";
l) Njohuritë mbi ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*", të ndryshuar;
m) Njohuritë mbi ligjin nr. 10/2023 "Për *informacionin e klasifikuar*";
n) Njohuritë mbi ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në fushën penale" dhe protokollin e saj shtesë*";
o) Njohuritë mbi ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999 "*Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale*";

[illegible]

4. [illegible] 84% [illegible] ... 8322 [illegible]

## 2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, sipas rubrikës së vlerësimit të mëposhtme:

a) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën (deri në 15 pikë);
b) Vlerësim me shkrim, (deri në 60 pikë);
c) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, (deri në 25 pikë)

Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë), nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit.

Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *"Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur"*, të Departamentit të Administratës Publike, faqa zyrtare www.dap.gov.al http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015

## 2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail) nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mbi rezultatin e vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit si dhe për intervistën e strukturuar me gojë.

[illegible]

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin Dumani

ME URDHËR DHE ME DELEGIM
DREJTUESI I CAKTUAR

Adnan Xholi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË